

Broshurë,  
3-mujori i dytë,  
2023




ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



# PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Prill - Qershor 2023



Zhvillimi i qëndrueshëm është harmonizimi i zhvillimit ekonomik, dhe mbrojtja e mjedisit për të plotësuar nevojat e të sotmes, pa rrezikuar mundësitë që edhe brezat e ardhshëm t'i shfrytëzojnë këto kapacitete dhe t'i përmbushin nevojat e veta.





**Banka Amerikane e Investimeve** dhuroi 40 pemë të llojit “kumbull e kuqe” për qytetin e Tiranës, të cilat u mbollën gjatë muajit qershor përgjatë rrugës së Kavajës.





**Banka Kombëtare Tregtare (BKT)** mori pjesë për të dytin vit radhazi në aktivitetin “Rathë Dhurues” organizuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Duke vlerësuar të 3 projektet e prezantuara, banka zgjodhi të mbështesë projektin e rigjallërimit të parkut “Marigo Posio” në Vlorë, i cili synon të krijojë një hapësirë rekreative të gjelbër dhe çlodhëse për moshat e treta dhe për fëmijët.

**Credins Bank:**


- ▶ Inaguroi parkun “Smart Credins”, në të cilin u mbollën 20 pemë dhe 3 stola ku janë inkorporuar pajisje për karikimin e telefonit dhe aksesimin e internetit. Parku modern është një hapësirë më shumë e gjelbër për kryeqytetin.
- ▶ Bashkëpunoi me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në Javën - Ide të Gjelbërta në mbështetje të ideve novatore, që nxisin, edukojnë dhe zhvillojnë komunitetin. Projekti përkrah start-up-et me ide të avancuara mbi mbrojtjen e mjedisit.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania:**

- ▶ Në Ditën Ndërkombëtare të Tokës, 22 prill, u dërgua tek i gjithë stafi një buletin informativ duke sjellë në vëmendje të të gjithëve ndikimin që ka mënyra e jetesës e gjithsecilit në planetin tonë.
- ▶ Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, në vitin e saj të 50-të, banka iu bashkua iniciativave të Grupit Intesa Sanpaolo. Këtë vit, banka ka ndërmarrë një nismë, ku për çdo financim të biznesit të vogël gjatë muajit qershor 2023, banka do të mbjellë një pemë në stinën e vjeshtës në zonën e Farkës, Tiranë.



Spjegimi i Komitetit të Sigurimit të Bankës, të cilin përfshijnë të gjithë stafin për të ndihmuar ndikimin e kësaj nismë.





## OTP Bank Albania:

E shtuna, 10 qershor, inicioi aktivitetin e parë të grupit të vullnetarëve "Green Hearts". Duke qenë se në muajin qershor ishte edhe "Dita Botërore e Mjedisit", 30 punonjës të OTP Bank Albania, bashkë me fëmijët e tyre, u mbledhën në fundjavë për të pastruar Kepin e Rodonit.



## Procredit Bank:

- ▶ Mori pjesë në Tirana Green 2030, akademi e organizuar nga Këshilli Mjedisor Tiranë dhe organizata jo fitimprurëse Friedrich Ebert Stiftung Tirana, që synon të fuqizojë ngritjen e kapaciteteve të të rinjve pjesëmarrës rreth çështjeve mjedisore.
- ▶ ProCredit Holding dhe bankat simotra ProCredit u bënë pjesë e "Western Balkans ESG Summit 2023". Ky samit mbledhi së bashku përfaqësues nga Ballkani Perëndimor dhe institucione të shumta evropiane, përfaqësues të biznesit nga sektori privat, si dhe ekspertë në fushën e standardeve të Qëndrueshmërisë Mjedisore. Në takim u diskutua mbi kontributet dhe përfshirja e Objektivave të Qëndrueshmërisë Mjedisore në ekonominë e Ballkanit Perëndimor. Të pranishëm ishin dhe përfaqësues nga Njësia Mjedisore e Procredit Bank Shqipëri.





### Banka Amerikane e Investimeve (ABI):

- Mbështeti dhe mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Turizmit “E ardhmja e Turizmit të Qëndrueshëm Mjedisor në Shqipëri” #FESTA.

### Banka Kombëtare Tregtare (BKT):

- Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së kushteve të mësimdhënies, banka ka mbështetur shkollë të ndryshme në Vlorë, Peqin, Korçë në pajisjen me kompjuterë për laboratorët informatikë. Gjithashtu, janë mbështetur aktivitete edukative dhe kulturore të organizuara nga nxënësit e shkollave, si shfaqja teatrale “Kopraci” organizuar nga nxënësit e shkollës “Fuat Babani”, Bilisht apo organizime seminaresh për zhvillim karriere për nxënës të shkollave të mesme.
- Mbështeti aktivitetin e përvitshëm “Young Innovators” të organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë, në kuadër të lëndës së Inovacionit. Në konkurs morën pjesë 120 ide novatore dhe fitues u shpall grupi 18 “Earthy Guide”, i cili krijoi një shërbim që bashkon njeriun me natyrën dhe jetesën e shëndetshme.

### Intesa Sanpaolo Bank Albania:

Më datë 25 maj 2023 u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve “Intesa Sanpaolo Bank Albania Awards”. Në edicionin e parë të kësaj iniciative, banka paraqiti fituesit për secilën kategori. Secila kompani u prezantua në sferën e aktiviteteve të biznesit dhe avantazheve konkurruese që e dallojnë subjektin në treg. Ceremonia e ndarjes së çmimeve u fokusua tek rëndësia e kompanive të nominuara në zhvillimin e ekonomisë vendase dhe shërbeu si një platformë promovuese e faktorëve shumëdimensionalë të suksesit të bizneseve fituese.

### Fibank Albania

Në kuadër të Panairit të Punës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës organizoi






Forumin “30 Vite Ekonomi e Lirë – Sektori Bankar”. Fibank ishte pjesë e këtij aktiviteti dhe është vazhdimisht në mbështetje të mundësive për zhvillimin e praktikës për studentët. Shumë prej këtyre studenteve u është ofruar edhe mundësia e punësimit me kohë të plotë dhe sot janë punonjësit tanë prej vitesh.

### Procredit Bank:

- ▶ Për herë të parë në Shqipëri u ofrua shërbimi i pagesave nga portofoli digjital me Google Pay. Procredit Bank solli një shërbim të ri për klientët e saj në lidhje me pagesat digjitale përmes Google Pay, një mënyrë e shpejte dhe e thjeshtë për të kryer pagesat direkt nga telefoni (contactless). Me Google Pay mund të kryhen pagesa online dhe në POS/ATM pa kontakt përmes celularit Android.
- ▶ Ka hapur aplikimin për Onboarding Programme, një praktikë disa vjeçare e Procredit Bank. Të rinjtë kanë mundësinë të trajnohen në qendrën e trajnimeve në Beograd, së bashku me koleget e tjerë të rinj të bankave rajonale Procredit dhe në përfundim të programit i u jepet dhe mundësia e punësimit në bankë.
- ▶ U nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Procredit Bank dhe Universitetit Mesdhetar (UMSH), e cila krijon mundësi të reja punësimi për studentët e këtij universiteti, si dhe përfshirjen e stafit akademik dhe profesional në projekte të përbashkëta me interes dypalësh.
- ▶ Së bashku me Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës u organizua leksioni i e hapur mbi investimet në energjinë e rinovueshme. Të pranishëm në takim ishin dhe përfaqësues të departamentit të burimeve njerëzore të bankës, të cilët diskutuan me studentët e pranishëm mundësitë e punësimit që ofron banka.
- ▶ Në workshop-in e organizuar gjatë





panairit “Ditët e Bujqësisë 2023”, ekspertë të biznesit të bankës informuan pjesëmarrësit në lidhje me investimet novatore në agrobiznes dhe mundësitë që banka ofron për fushën e agrikulturës.

### Tirana Bank:

- ▶ Për të dytin vit radhazi, mbështeti Konkursin e Bizneseve të Gjelbra, organizuar që nga viti 2012 nga Partners Albania. Ndër idetë interesante juria përzgjedhi 2 fitues për fazën e ideve konceptuale të biznesit dhe 3 fitues për biznes në fazë zhvillimi. Mbështetja financiare e Tirana Bank për këtë program pati si synim promovimin e koncepteve të qëndrueshme biznesi që përputhen me vlerat e institucionit.
- ▶ Realizoi me sukses partneritetin me Junior Achievement Albania në realizimin e Festivalit GEN-E Albania. Festivali ofron një mundësi për gjimnazistët që të bashkohen, të akordojnë aftësitë e tyre dhe të zhvillojnë ide të reja si dhe të fitojnë njohuri të vlefshme për sipërmarrjen. Në këtë edicion mbi 2,500 të rinj ishin pjesëmarrës duke krijuar rreth 70 kompani të cilat adresonin nevojat e ndryshme të tregut si ekonomia e gjelbër, IT dhe inovacion, shërbime për dizajn website dhe aplikacione. Juria përzgjedhi fitues grupin e të rinjve nga Instituti “Harry T. Fultz” Tiranë me kompaninë “Fistrat” i cili kishte në fokus dizajnimin e rrjetit dhe aplikacioneve.

### Union Bank:

- ▶ U prezantua në panairin “Expo Turizëm” organizuar nga Expocity Albania në datat 6-8 prill, me paketa të dedikuara për të gjitha bizneset e sektorit të turizmit duke plotësuar nevojat për investime dhe zgjerimin e aktivitetit me kushte dhe përfitime të favorshme.
- ▶ Përgjatë 3 ditëve të panairit “Ditët e





Bujqësisë 2023”, i cili u zhvillua në qytetin e Lushnjës në datat 27-29 prill, vizitorët patën mundësi të marrin informacion të vlefshëm, duke u prezantuar me produktet që Union Bank offton për të gjithë sektorin Agro.

### Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA):

Drejtori i Përgjithshëm i UBA, z. Orfea Dhuci mbajti një leksion të hapur në Universitetin Barleti. Takimi u përmyll me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy institucioneve, e cila ka si qëllim parësor pjesëmarrjen e studentëve të universitetit në praktika mësimore pranë UBA Bank, si dhe organizimin e veprimtarive të përbashkëta.

### PANAIRI “DUA TË PUNOJ”

Credins Bank, Union Bank dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA) ishin pjesë e këtij panairi të parë të zhvillimit të karrierës dhe të punësimit për personat me aftësi të kufizuara, organizuar më 29 maj nga Fondacioni Down Syndrome Albania në kuadër të projektit EMPOWER – Edukim dhe mbështetje për punësimin e të rinjve me aftësi të kufizuara, me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.









### PANAIRE NË UNIVERSITETE:

Bankat janë pjesë aktive dhe mbështesin panairët të ndryshme të Punës dhe Karrierës që organizohen nga institucione të ndryshme në vend. Qëllimi i këtyre panairove është informimi i studentëve të interesuar për praktika dhe mundësi punësimit.

**Credins Bank** mbështeti fakultetin Ekonomik në panairin “E ardhmja plotë dritë”, si dhe panairin “Work and Study” organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** ishte e pranishme në Panairin e 10-të të Karrierës të organizuar nga Universiteti Epoka dhe në Panairin e Punës dhe Karrierës në Universitetin Aleksandër Moisiu, në Durrës.

**Procredit Bank** pjesë e Panairit Work & Study i zhvilluar në Pallatin e Kongreseve, si dhe Panairit të Punës në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.







### Banka Amerikane e Investimeve (ABI):

Në muajin prill nisi bashkëpunimin më të ri me Fondacionin dhe Bankën Credins, duke qenë partnere së bashku në platformën e dhurimeve Smile.al. Përgjatë këtyre muajve, ABI Bank ka kryer dhurime për 8 projekte të ndryshme, duke patur gjithnjë në vëmendje zhvillimin dhe mbështetjen në plotësimin e nevojave të shoqërisë; si vijojnë:

- ▶ Trauma në fëmijëri – Alo!Mik! Projekti ka për qëllim realizimin: (1) Aktivitete psikosociale me fëmijët për të eksploruar strategji për t'u vetë rregulluar emocionalisht; (2) Seancat e terapisë me lojra për të ndihmuar në vlerësimin dhe përpunimin e traumës në jetën e fëmijëve; (3) Trajnimi dhe pajisja e 50 personave që punojnë me fëmijet në qendrat ditore apo rezidenciale.
- ▶ Ndihmë financiare në mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve të prekur nga tërmeti në Turqi në 6 shkurt 2023 – projekt nga Caritasi Shqiptar.
- ▶ Rrugëtimi i ndryshëm, i njëjti destinacion – Shoqata Orart. U mbështet realizimi shfaqjes me fëmijët e shkollës Zyber Hallulli.
- ▶ Mike në lagjen time - Qendra Mbështetje Informacion Kujdes Edukum (M.I.K.E). Nëpërmjet mbështetjes së këtij projekti u mundësua blerja e lpad dhe biçikleta.
- ▶ Projekti: Ekipi i të Amputuarve Shqiptar 2019. U mundësua blerja e patericave dhe veshjeve për ekipin e të amputuarve shqiptarë.
- ▶ Mbështetje emergjente për të mbijetuarat e dhunës dhe fëmijët e tyre në momentin e denoncimit të dhunës (OJF: Woman Forum Elbasan). Projekti synoi mbështetjen e 5 grave të dhunuara.
- ▶ Kualifikimi teorik dhe praktik i mësuesve të lëndës së edukimit fizik të shkollave të vendit. Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar me ekspertë të Federatës Shqiptare të Sportit Shkollor, u bë e mundur ngritja e projektit cili synon të kontribuojë në uljen e sedentaritetit dhe përmirësimin e aktivizimit fiziko-lëvizor të të rinjve, duke ndihmuar në zhvillimin e një fiziku të shëndetshëm.
- ▶ Projekti OriginAL një udhëtim për të zbuluar rrënjët. Projekti synon realizimin e kthimit të të rinjve, të cilët, në shumë raste, nuk kanë qenë kurrë në vendlindje.
- ▶ Mbështetje për zhvillimin e shërbimeve terapeutike për 25 fëmijë me aftësi ndryshe. ABI Bank mori pjesë në eventin “Rathë Dhurues”, duke mbështetur nismën e Fondacionit Global Care Albania për zhvillimin e shërbimit të specializuar për 25 fëmijë me aftësi ndryshe, në zonën e Bathores.

### Credins Bank:

- ▶ “MICE” – Projekti që bëri bashkë dizajnë, aktivistë, arkitektë për promovimin mbi potencialin infrastrukturor që Shqipëria ka në organizimin e eventeve, konferencave, aktiviteteve turistike, etj., për të promovuar turizmin në Shqipëri.
- ▶ Lojrat Olimpikë – Polini 2023: Credins është sponsor zyrtar i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.
- ▶ “Dekada”- “Kape Bitin”: Eventi artistik i vitit, i cili erdhi me protagoniste kryesore këngëtaresh e famshme Elvana Gjata. Ky event u sponsorizua zyrtarisht nga Credins Bank dhe Mastercard dhe erdhi njëherazi edhe si një bashkëpunim i dy brand-eve të mirënjohura në industrinë bankare në realizimin e një fushate shpërblyese për klientët e tyre besnik.
- ▶ “Arti në rrugëtimin tonë” – Ekspozita që solli me rastin e 20 vjetorit të Credins Bank 20 piktura, nga 20 piktorët më të mirë në Shqipëri.





### Intesa Sanpaolo Bank Albania:

- ▶ Gjatë muajit prill, Intesa Sanpaolo Bank Albania ftoi të gjithë punonjësit të merrnin pjesë në konkursin e brendshëm lidhur me Eurovision Song Contest 2023 Edition.
- ▶ Puna në një botë në ndryshim, është iniciativa e ndërmarrë nga Intesa Sanpaolo Bank Albania dedikuar brezit të ri në bankë. Qëllimi i kësaj iniciative është të zbulojë se çfarë do të thotë për të rinjtë të punosh në një botë në ndryshim, si dhe çfarë i frymëzon ata më shumë në punën e përditshme.

### Fibank Albania:

- ▶ Në partneritet me Fondacionin Spitalor Nënë dhe Fëmijë dhe Fibank Albania, në kuadër të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave dhe në prani të përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkisë së Fier, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe partnerë zbatues nga institucionet shtetërore dhe shoqëria civile, u mblodhëm në hapjen e ekspozitës me fotot e vajzave shqiptare dhe siluetat e atyre vajzave që mungojnë mes nesh. #tjeterheremevajzeFier.
- ▶ Mbështet organizimin e garave në natyrë nga Illyian Race.

### Banka OTP Albania:


Ka dhuruar mobilje dhe pajisje kompjuterike në institucione në disa zona të Shqipërisë duke kontribuar kështu në një përmirësim të mjedisit të punës dhe shërbimit qytetar.

### Procredit Bank:

U bë pjesë e panelit të forumit “30 Vite Ekonomi e Lirë – Sektori Bankar” organizuar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës. Në panel ishte edhe z. Mirsad Haliti, anëtar i Bordit Drejtues të Procredit Bank Albania, i cili paraqiti opinionet e tij mbi ndikimin e bankave në ekonominë e vendit, zhvillimin e sektorit bankar në Shqipëri si dhe mundësitë që banka ofron për të gjithë të rinjtë që synojnë të nisin karrierën në një bankë digjitale.

### Tirana Bank:

- ▶ Kontribuoi në ngritjen e laboratorit të informatikës në shkollën “5 Dëshmorët” në Ksamil, Sarandë. Pajisja me kompjuterë do të mundësojë nxënësit të praktikohen dhe rrisin njohuritë në fushën e teknologjisë dhe IT, duke krijuar kështu kushte më të mira për një edukim edhe më cilësor.
- ▶ Në mbështetje të kërkesës së Drejtorisë Arsimore në Pogradec, bëri të mundur ndërtimin e





laboratorëve të informatikës dhe fizikës në dy institucione arsimore në këtë qytet, duke siguruar për Shkollën e Mesme “Muharrem Çollaku” pajisje elektronike për laboratorin e informatikës dhe për shkollën 9-vjeçare “Koli Gusho” mobilimin e laboratorit të fizikës.

- ▶ Mbështeti Idromeno film festival organizuar në qytetin e Shkodrës në qershor. Aktiviteti 7 ditor synoi të ndërtojë një mentalitet të ri në vend mbi kino-realitetin shqiptar.
- ▶ Mbështeti UNUM Festival 2023, festivali “open air” i muzikës house & techno organizuar në Shëngjin, Lezhë, në muajin qershor. 85 artistë, 3 skena dhe 24 orë muzikë pandërprerë për 6 ditë.
- ▶ Mbështet përmirësimin e kushteve hidro-sanitare në Shtëpinë e Foshnjës, Vlorë. Mbështetja e këtij projekti u realizua në një sinergji të plotë të implementimit të projektit si pjesë e politikave të përgjegjshmërisë sociale të bankës nga njëra anë dhe me kontributin vullnetar të stafit ofruar për projektin e organizuar së brendshmi, Kid’s Corner, me mesazh kryesor “Fëmijët për Fëmijët” nga ana tjetër. Me qëllim inkurajimin e krijimtarisë tek fëmijët e stafit, si edhe përforcimin e marrëdhënies në ekip, stafi i bankës u inkurajua të kontribuonte në motivimin e punës krijuese të fëmijëve duke ofruar pagesa simbolike për pikturat dhe krijimet e tyre. Të gjitha fondet e mbledhura në këtë projekt do të shkonin për një kauzë të vecantë nën mesazhin “Fëmijët për Fëmijët.”

### Union Bank:

- ▶ Kontribuoi në financimin e monumentit kushtuar shenjtores Nënë Tereza, realizuar nga skulptori Ilirjan Shima, e cila tashmë ndodhet në ambientet e Aeroportit Ndërkombëtar që mban emrin e saj.
- ▶ Sponsor zyrtar i Colourday Festival, i cili u zhvillua në datë 25 maj në sheshin “Skënderbej”.
- ▶ Mbështeti edicionin e 12-të të Konkursit Edukativ Kombëtar “Të sigurt mbi dy rrota” organizuar nga Automobile Club Albania gjatë periudhës prill-qershor 2023 me pjesëmarrjen e fëmijëve nga 10 qytete të vendit. Në vendin e parë u rendit ekipi nga shkolla “Ismail Qemali” në Shkodër, i cili do të përfaqësojë Shqipërinë në Konkursin Evropian të Sigurisë Rrugore.

### DHURIM VULLNETAR GJAKU

Kjo nismë organizohet prej disa vitesh në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe me pjesëmarrjen vullnetare të punonjësve të bankave për të ardhur në ndihmë fëmijëve talasemikë dhe personave që kanë nevojë për gjak.

**Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Fibank Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania, ProCredit Bank, Union Bank dhe Banka e Bashkuare Shqipërisë (UBA)** organizuan në ambientet e tyre seancat e dhurimit të gjakut.

